

VENDIM
Nr.73, datë 17.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i“““

Hajredin Fuga, Anetar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Bardha Selenica, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datë 23.11.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.68 Akti që i përket:

KERKUESE: OLIMBI PRIFTI, e përfaqësuar nga Av.Dhimitër Zhulla.

SUBJEKT I INTERESUAR: ENGJELL ALLAJBEU, në mungesë.

OBJEKTI:

Deklarimin antikushtetues të vendimeve nr.1187, datë 26.7.1996 të gjykatës së rrethit Gjirokastër; nr.5578, datë 16.10.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.959, datë 30.7.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesia, ka parashtruar si shkaqe për antikushtetutshmërinë e vendimeve të sipërcituara, zbatimin e gabuar të ligjit në kohë nga ana e gjykatave, si dhe mohimin e të drejtave të saj ligjore si rrjedhojë e moszhvillimit të një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të kërkueses si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Shkaqet e parashtruara nga ana e kërkueses si argument ligjor për shpalljen antikushtetues të vendimeve të tre gjykatave, nuk qëndrojnë dhe për rrjedhojë kërkesa nuk duhet pranuar.

Gjykatat, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar midis palëve ndërgjyqëse, në bazë të një kontrate huaje të lidhur më datën 2.4.1994, kanë zbatuar dispozitat ligjore të Kodit Civil që aktualisht është në fuqi, duke e detyruar kërkuesen që t'i kthejë subjektit të interesuar shumën prej 36.168.000 Dhehmi, ku përfshihet detyrimi kryesor në shumën 8.300.000 Dhehmi, si dhe interesi prej 12 % në muaj deri në datën 2 korrik të vitit 1996.

Kërkuesia ka pretenduar se referimi ligjor nga ana e Gjykatës, në dispozitat e Kodit të ri Civil (në një kohë që duhej zbatuar kodi i mëparshëm, sepse marrëdhënia juridike ka lindur në atë kohë) i ka cënuar të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të rregullt, sepse kodi i mëparshëm civil në dallim nga ai që është në fuqi sot, nuk e parashikonte marrjen e huasë në të holla me shpërblim si dhe njihte vetëm kamatën sipas interesit bankar. Prandaj, dhe gjykatat sipas kërkueses, padrejtësisht kanë vendosur për kërkuesen një detyrim të tillë në të holla që nuk parashikohej në atë masë nga legjislacioni civil i kohës.

Nga pikëpamja formale juridike, është e vërtetë që sipas nenit 1166 të Kodit Civil, për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje juridike të lindur nga një kontratë huaje që mban datën 2.4.1994 dhe me afat 2 mujor, duhej të ishin zbatuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1982 dhe jo dispozitat ligjore që ekzistonin në kohën e ngritjes së kërkesë padisë. Njëkohësisht duhet pranuar se zbatimi nga ana e gjykatës i dispozitave të Kodit të Ri Civil të vitit 1994, në rastin konkret nuk përbën shkak për shpalljen antikushtetues të vendimeve gjyqësore.

Kodi Civil i vitit 1982, që bazohej mbi Kushtetutën e vitit 1976, rregullonte marrëdhëniet juridike të një shoqërie me ekonomi shtetërore të centralizuar që nuk lejonte ekzistencën e pronës private dhe të iniciativës së lirë për shtetasit.

Në bazë të këtij parimi, janë parashikuar të gjitha dispozitat e tjera të Kodit Civil, duke përfshirë dhe nenin 303, që nuk lejonte shpërblimin në kontratën e huasë midis shtetasve, apo nenet 160/2 dhe 168/3 që për rastet e mospërbushjes së detyrimeve njihnin vetëm kamatën ligjore që nuk kalonte kufijtë e interesit bankar.

Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe ligji nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit”, për herë të parë parashikuan parime të reja dhe krejtësisht të ndryshme nga ato që ekzistonin në legjislacionin civil të kohës. Këto dispozita të reja, jo vetëm sanksionojnë dhe mbrojnë pronën private dhe iniciativën e lirë midis shtetasve, por njëkohësisht në mënyrë të heshtur i bëjnë të pazbatueshme, të gjitha ato dispozita ligjore që vijnë në kundërshtim me frymën e tyre.

E parë në këtë këndvështrim kohor dhe ligjor, nuk mundet që të kishin më fuqi juridike dispozitat e mëparshme, qoftë dhe të Kodit Civil, të cilat binin haptazi në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjet e kohës. Gjithashtu kontrata e huasë e lidhur midis palëve ndërgjyqëse duhet parë në harmoni me të gjithë legjislacionin e ri dhe veçanërisht me dispozitat kushtetuese. Kjo marrëveshje midis tyre përderisa nuk bie ndesh me dispozitat kushtetuese, për rrjedhojë ajo nuk mund të konsiderohet as në kundërshtim me Kodin Civil.

Meqënëse dispozitat ligjore në fuqi nuk ndalonin shtetasit të kontraktin në forma të ndryshme, duke qenë se palët në këtë kontratë me vullnetin e tyre të lirë, kanë pranuar kushte të tilla ndaj njëri-tjetrit, dhe përderisa kjo marrëveshje individuale midis tyre nuk dëmtonte interesat e përgjithshme të shoqërisë, atëherë nuk mund të pretendohet për antikushtetutshmëri të vendimeve gjyqësore.

PER KETO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.